

# Mbështetja për Reformat Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor



Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është në procesin e zbatimit të Projektit “Mbështetje për reformat zgjedhore në Ballkanin Perëndimor” me qëllim mbështetjen e institucioneve dhe të shoqërisë civile në përpjekjet e tyre për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për vëzhgimin e zgjedhjeve. Objekti i këtij projekti mbulon disa fusha që lidhen me administrimin e zgjedhjeve, regjistrimin e zgjedhësve, rolin dhe punën e mediave gjatë fushatave zgjedhore, aftësinë e partive dhe të kandidatëve për të bërë fushata lirisht, si dhe kapacitetin dhe pavarësinë e organeve që zgjidhin mosmarrëveshjet zgjedhore.

## 5 fusha tematike

Mbështetje për partnerët vendas dhe ndërkombëtarë në përpjekjet e tyre për:

- Rritjen e kapaciteteve të organeve të administrimit të zgjedhjeve për administrimin e zgjedhjeve në mënyrë të efektshme, të paanshme dhe transparente;
- Rritjen e saktësisë së listave të zgjedhësve dhe të proceseve të regjistrimit të zgjedhësve, duke përfshirë edhe bashkërendimin efikas me regjistrat civilë dhe kontrollin nga publiku të listave të zgjedhësve;
- Përmirësimin e njohurive dhe rritjen e kapaciteteve të organeve rregullatore të medias për monitorimin dhe rregullimin e sjelljes së mediave gjatë zgjedhjeve, duke kontribuar kështu në një mjedis zgjedhor pluralist dhe objektiv;
- Përmirësimin e rregullave të fushatës zgjedhore dhe praktikave, me qëllim që partitë dhe kandidatët të kenë mundësi t'i paraqesin pikëpamjet e tyre lirisht, pa ndëshkime administrative, dhunë apo kanosje, dhe përmes mekanizmave të deklarimit dhe zbatimit të financimit të fushatës, të cilat nxisin rritjen e transparencës dhe llogaridhënies;
- Rritjen e kapaciteteve dhe pavarësisë së organeve që zgjidhin mosmarrëveshjet zgjedhore, duke përfshirë edhe organet e administrimit të zgjedhjeve dhe gjykatat, në mënyrë që mosmarrëveshjet zgjedhore të gjykohen në mënyrë të efektshme, duke kontribuar kështu në integritetin e zgjedhjeve, në besimin e publikut në procesin zgjedhor, si dhe në sundimin e ligjit.

## Fokusi

Ky projekt, i cili filloi në janar të vitit 2021 me financimin e Bashkimit Evropian dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, po vazhdon tashmë të zbatohet me financimin e Gjermanisë dhe Norvegjisë. Projekti ofron asistencë për Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Ai ofron asistencë edhe për Kosovën.\* Veprimtaritë bazohen në rekomandimet e misionëve të mëparshme të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve. Zgjedhjet në Kosovë vëzhgohen nga Bashkimi Evropian dhe, në këtë rast, merren për bazë rekomandimet e Bashkimit Evropian.

Projekti nisi në vitin 2021 dhe mbështetet në punën e kryer nga Projekti "Mbështetje për zgjedhjet në Ballkanin Perëndimor", i cili u zbatua gjatë periudhës 2017-2020. Megjithatë gjatë fazës së parë të Projektit, mbështetja e ODIHR-it çoi në njëfarë ecurie në zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet, nevojitet asistencë e mëtejshme për shqyrtimin e rekomandimeve në mënyrë të gjithanshme dhe për ta ndjekur zbatimin e tyre në mënyrë të efektshme.

"Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga misionet vëzhguese të zgjedhjeve të ODIHR-it dhe Bashkimit Evropian është një hap i rëndësishëm që duhet ndërmarrë me qëllim rritjen e stabilitetit të institucioneve, mbrojtjen e demokracisë dhe rritjen e besimit të publikut në proceset zgjedhore. Janë pikërisht këto objektiva themelore ato që udhëheqin punën e ODIHR-it në mbështetjen e partnerëve tanë vendas dhe ndërkombëtarë që punojnë për zgjedhjet në Ballkanin Perëndimor."

**Matteo Mecacci**  
Drejtor, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

## Veprimtaritë

Projekti punon për të mbështetur partnerët përmes seminareve tematike rajonale me veprimtari praktike, asistencës së thelluar ligjore dhe teknike, shkëmbimeve të përvojave pozitive mes profesionistëve në nivel rajonal dhe nënrajonal dhe rritjes së ndërgjegjësimit lidhur me reformat zgjedhore në nivel rajonal dhe në nivelin e përfituesve përkatës. Projekti konsiston në një sërë veprimtarish të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe është fleksibël ndaj përshtatjes së konkluzioneve të proceseve këshillimore dhe kërkesave të reja për asistencë.



## Reformë gjithëpërfshirëse dhe partneritet

Një reformë e qëndrueshme duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe duhet të kryhet nga aktorët e përfshirë në procesin zgjedhor. Ky Projekt mbështet mekanizmat e reformës ekzistuese që kanë të bëjnë me shoqërinë civile dhe me palët e tjera të interesuara. Vëmendje i kushtohet gjithashtu edhe angazhimit të grupeve të papërfaqësuar mjaftueshëm politikisht, duke përfshirë gratë, pakicat kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuara.


Ky projekt punon nga afër me organizatat ndërkombëtare, me qëllim që veprimtaritë e tij të jenë plotësuese të ndihmave të tjera ekzistuese në këtë drejtim. Këtu përfshihet edhe bashkëpunimi dhe këshillimi i ngushtë me Misionet në terren të OSBE-së, Delegacionet e Bashkimit Evropian dhe vendet që kanë ratifikuar deklaratën e Kombeve të Bashkuara, *Deklarata e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve* (2005).

## Historiku

Në Samitin e Stambollit të vitit 1999, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan për të ndjekur zbatimin e vlerësimeve dhe rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet. Shtetet vlerësuan gjithashtu edhe asistencën që mund të japë ODIHR-i për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit zgjedhor. ODIHR-i e ka mbështetur vazhdimisht ndjekjen e zbatimit të efektshëm të rekomandimeve dhe Manuali i tij për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve për Zgjedhjet, i vitit 2016, ravigjeron qasjen e ODIHR-it në këtë fushë të rëndësishme. Bashkimi Evropian, duke njohur rëndësinë e reformave demokratike për aspiratat lidhur me integrimin evropian në rajon, ka vënë gjithashtu në dukje nevojën për të mbështetur ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të ODIHR-it.

\* Të gjitha referimet në këtë tekst ndaj Kosovës, qoftë ndaj territorit, institucioneve apo popullsisë, duhen kuptuar në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

**Për informacion të mëtejshëm lidhur me projektin dhe për të hyrë në bibliotekën e Projektit, jeni të lutur të futeni në adresën:** <http://www.osce.org/odihr/wb> ose të kontaktoni adresën: [wb-project@odihr.pl](mailto:wb-project@odihr.pl)



**OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights**

Ul. Miodowa 10  
00-251 Warsaw  
Poland

Office: +48 22 520 06 00  
Fax: +48 22 520 06 05  
[office@odihr.pl](mailto:office@odihr.pl)  
[www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr)

Follow OSCE and ODIHR

